



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**"ISA BOLETINI"**

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it  
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1320  
Dt 01.11.2016

Në bazë të nenit 48 pika 1.3, nenit 154 dhe nenit 157 të Statutit të Përkohshëm, Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 28.10.2016, mori:

**VENDIM**

1. **Dr. sc. Islam Qerimi** zgjidhet **profesor asistent** për grup lëndësh nga lëmi penal, në Fakultetin Juridik.
2. Zgjedhja e të përmendurit është bërë në pajtim me kushtet e parapara në nenin 157 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit.
3. I përmenduri është i obliguar që t'u përmbahet dispozitave të Statutit të Përkohshëm të Universitetit.
4. Zgjedhja zgjat për periudhën 4 (katër) vjeçare.
5. Të përmendurit i takon paga në pajtim me Rregulloren për të ardhura personale të UMIB-it.
6. Kontrata e punës me të përmendurin do të lidhet pas përfundimit të procedurave të ankesave.

**Arsyetim**

Universiteti i Mitrovicës ka shpallur konkurs për zgjedhjen e një mësimdhënësi për grup lëndësh nga lëmi penal, në Fakultetin Juridik.

Komisioni i Studimeve e ka shqyrtuar raportin e Komisionit recensues dhe i ka propozuar Senatit të Universitetit që dr. sc. Islam Qerimi të zgjidhet profesor asistent për lëndët e sipërpërmendura.

**Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 28.10.2016, duke pasur parasysh propozimin e Komisionit për Studime, vendosi që dr. sc. Islam Qerimi të zgjidhet profesor asistent për grup lëndësh nga lëmi penal, në Fakultetin Juridik.**

Në bazë të kësaj që u tha më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Senatit të Universitetit.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Të përmendurit;
3. Fakultetit;
4. Zyrës së personelit;
5. Zyrtarit për paga;



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it